

 REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO Gjykatë Kushtetuese / Ustavni Sud / Constitutional Court			
Njësia org Org. Jed Org. Unit	DRLSA	Nr. Prot Br. Prot Prot.No	1039
Nr. i faqeve Br. stranca Pages	4	Data Datum Date	05.06.19

NJOFTIM

PËR: Z. MILOT VOKSHI, SEKRETAR I GJYKATËS KUSHTETUESE
PREJ: RINA KIKA, AVOKATE
NË LIDHJE ME: **NJOFTIM PËR LËNDËN KI 108/18**
DATA: 05 QERSHOR 2019

Pranuar / Primitje	
05 JUN 2019	
Ne ora	kasova

I nderuar Z. Vokshi,


Po ju drejtohem si përfaqësuese e Z. Blert Morina sipas autorizimit në shkresat e lëndës.

Bazuar në kërkesën tuaj që për çdo zhvillim të ri në lidhje me rastin e Z. Blert Morinës të ju informojmë të cilën e keni shprehur në përgjigjen e datës 12 prill 2019, ju njoftojmë që sot, më datë 05 qershor 2019, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, përmes postës së rregullt kemi dërguar kërkesën e katërt për përsheptim të procedurës për Padinë për konflikt administrativ të datës 24 korrik 2018, të cilën po ju dërgojmë bashkëngjitur me këtë njoftim.

Tri kërkesat tjera për përsheptim të procedurës i janë dërguar Gjykatës Themelore më 4 dhjetor 2018, 22 mars 2019 dhe 16 prill 2019. Gjykata Themelore ende nuk na ka dërguar asnjë ftesë, thirrje, apo kërkesë tjetër në lidhje me Padinë për konfliktin administrativ.

Me respekt,

Rina Kika LLM
 Avokate
rina@kika-associates.com
 +383 49 355 722
 Rr. Edith Durham B1 H1 Nr.11
 10000 Prishtinë
 Kosovë



Avokate - Attorney at law RINA KIKA Prishtinë
--



SISTEMI I AUTOMATIZIMIT TË SPORTELEVE TË POSTËS SË KOSOVËS

POSTA E KOSOVËS

Zyra postare :
Post Office: **PRISHTINA 2 (OAF)**
Postanski ured:

Nr. serik :
Serial no. **20612019610612**
Serijski br.

DËFTESË PËR PRANIMIN E DËRGESËS/CERTIFIKATE OF DISPATCH'S ON ADMISSION/POTVRDA O PRIJEMU POSILJKE

Dërgesa: Mail: Posiljka	Letrat	Nr. i pranimit: Reception No Prijemni br.	7351173	Data: Date: Datum:	05/06/2019
Marrësi: Recipient: Primalac:	GJ,THEM, NE PR, DEP, PER ÇESHTJE ADMINISTRATIVE				
Adresa e marrësit: Address of the recipient: Adresa primaoca:	PRISHTINE ,Hajvali				
Shërbime të veçanta: Particulares services: Posebne usluge:	R				
	Vlera/Value/Vrednost 0.00				
Vërtetësinë e shënimeve e vërteton dërguesi:	Kundërpagesa/Counter payment/Otkupnina 0.00				


Pesha
Weight **20.000** **Gr**
Tezina

Taksa postare
Post. Tax **1.00** **€**
Postarina

Vërejtje: Të ruhet në rast reklamacioni
Remars: Keep in case of advertising
Napomena: Da se sacuva u slucaju reklamacija

Nëshkrimi
Signature
Potpis

Sinan Bajrami



GJYKATËSIT TË LËNDËS
GJYKATA THEMELORE PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR ÇËSHTJE ADMINISTRATIVE
PRISHTINË

PADITËSI: Blerta Morina me numër personal [REDAKTUAR], e përfaqësuar nga Avokatja Rina Kika, me adresë në Rr. Miss Edith Durham B1 Hyrja 1 Nr. 11, 10000 Prishtinë, (sipas autorizimit në shkresat e lëndës)

E PADITURA: Agjencia për Regjistrimin Civil, Ministria e Punëve të Brendshme

DATA: 05 qershor 2019

KËRKESË E PËRSËRITUR PËR PËRSHPEJTIMIN E PROCEDURËS
LIDHUR ME PADINË PËR KONFLIKT ADMINISTRATIV

I/e nderuar/a Z./Znj. Gjykatës/e,

Po ju drejtohem si përfaqësuese e Z. Blert Morina sipas autorizimit në shkresat e lëndës. Me anë të kësaj shkrese, ne përsëri kërkojmë që të përshpejtohet procedura e shqyrtimit të padisë për konflikt administrativ të Z. Blert Morina të dorëzuar me datë **24 korrik 2018** kundër Vendimit Nr. 64-04 të Agjencisë për Regjistrimin Civil. Me këtë vendim është refuzuar kërkesa e Z. Morina për ndërrimin e emrit nga “Blerta” në “Blert” dhe ndërrimin e shënuesit të gjinisë nga “F” në “M”.

Më **4 dhjetor 2018**, kemi dërguar kërkesën e parë në Gjykatën Themelore, Departamenti për Çështje Administrative për përshpejtimin e procedurës në lidhje me Padinë për Konflikt Administrativ. Në të njëjtën shkresë, janë të elaboruara rrethanat dhe rëndësia e këtij rasti për Z. Morina si personi i parë transgjinor i cili kërkon nga shteti i Kosovës t’i njihet ligjërisht identiteti gjinor ashtu që të ndërrohen të dhënat e tij personale – emri dhe shënuesi i gjinisë, në përputhje me identitetin e tij gjinor. Më **22 mars 2019** kemi dërguar kërkesën e dytë dhe më **16 prill 2019** kemi dërguar kërkesën e tretë për përshpejtim të procedurës në lidhje me shqyrtimin e padisë së Z. Morina. Kjo është kërkesa e katërt për përshpejtim të procedurës për shqyrtimin e padisë së Z. Morina.

Ritheksojmë se përveç ndikimit në jetën e Z. Morina, ky rast ka ndikim të përgjithshëm në jetën e komunitetin transgjor në Kosovë. Kërkojmë që ta shqyrtoni padinë me procedurë të përshpejtuar në mënyrë që të evitohen shkeljet e vazhdueshme të së drejtës së privatësisë dhe të drejtës për trajtim të barabartë për Z. Blert Morina.

Me respekt,

Rina Kika LL.M.

Avokate

Kika & Associates ShPK

T +386 49 355 722

E rina@kika-associates.com

